



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 79 Datë 23 . 12 . 2022

PËR

**NDRYSHIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË  
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, (i ndryshuar), Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”,

VENDOSI

1. Ndryshimin e Tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, (miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022), bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55/6, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI  
Anilda BIBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

## P/VENDIM

Nr. 83 Datë 22.12. 2022

### PËR

### **NDRYSHIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.23 date 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, (i ndryshuar), Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

#### **MIRATIM:**

1. Ndryshimin e Tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, (miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022), bashkëngjitur këtij projekt - vendimi.

**KRYETARI**  
**Safet GJICI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

## RELACION

### KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

#### PËR

### NDRYSHIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Udhëzimit Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Kukës, është mbështetur në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, ka përgatitur dhe po paraqet për miratim para Anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Kukës, ndryshimet në tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 tavane të cilat janë miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022, në nivel programi buxhetor.

Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2023-2025, i cili duhet theksuar se mbetet i njëjti, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.19 datë 13.01.2022, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, Bashkia Kukës ka analizuar burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj. Këto vlerësime si për të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore edhe për Bashkinë Kukës përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm, duhet



theksuar se i vetmi ndryshim që na detyroi të bëjmë ndryshimin e Tavanëve të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 është Shkresa nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”.

Bashkia Kukës në hartimin e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2023-2025 dhe konkretisht në procedurat për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 është mbështetur në kuadrin ligjor të miratuar para dhe gjatë vitit 2022.

Kështu bazuar në Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Kurset e këmbimit për vitet 2018-2022, dhe parashikimi për vitet 2023-2025, bazuar në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, jepen si më poshtë:

| Nr | Monedhat                         | 2018  | 2019  | 2020  | 2021  | 2022  | 2023  | 2024  | 2025  |
|----|----------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| 1  | Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD  | 108   | 109.9 | 108.6 | 103.5 | 103.5 | 103.5 | 103.5 | 103.5 |
| 2  | Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO | 127.6 | 123   | 123.8 | 122.5 | 122.5 | 122.5 | 122.5 | 122.5 |

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Kukës së bashku me transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale (transfertën specifike) si dhe transferta e kushtëzuar (Fondet e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë, Gjendjes Civile dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit), kanë financuar funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2022. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen, niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj dhe kjo do të na bëhet e ditur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Transferta e pakushtëzuar për periudhën 2023-2025, bazuar në Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (në rang kombëtar) për periudhën 2023-2025, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

| Vitet  | <i>në milionë lekë</i> |        |        |
|--|------------------------|--------|--------|
|  | 2023                   | 2024   | 2025   |
| Transferta e Pakushtëzuar (në rang kombëtar) | 19,870                 | 21,070 | 22,350 |

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë Kukës për periudhën 2023-2025, bazuar në Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, ndryshuar me Shkresën nr.19206 prot. Datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transfera e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Shtojca 1 “Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë Kukës për periudhën 2023-2025

*në mijë lekë*

| <b>Bashkia</b> | <b>2022</b><br>(VKB Nr.71 Datë<br>24.12.2021) | <b>2023</b><br>(Shkresa nr.19206<br>prot. Datë<br>19.10.2022) | <b>2024</b> | <b>2025</b> |
|----------------|---|---|-------------|-------------|
| Bashkia Kukës  | 329,778                                       | 382,071   | 389,712     | 397,507     |

Sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025” dhe Udhëzimit Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, theksohet se Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2023-2025 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në përllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2023-2025 janë:

- popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit),
- dendësia e popullsisë për km<sup>2</sup>,
- numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Madhësia e koeficientëve dhe të dhënat e nevojshme për llogaritjen e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2023-2025 do të jenë në përputhje me përcaktimet e Ankesit 1, të ligjit vjetor të buxhetit 2022.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale (transfera specifike) sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2023-2025 do të jetë referuar treguesve kryesor të kuadrit makroekonomik e fiskal 2023-2025 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.19 datë 13.01.2022. Transfera e Pakushtëzuar Sektoriale (në rang kombëtar) po sipas udhëzimit të mësipërm , për periudhën 2023-2025, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

*në milionë lekë*

| <b>Vitet</b>   | <b>2023</b> | <b>2024</b> | <b>2025</b> |
|--|-------------|-------------|-------------|
| Transfera e Pakushtëzuar Sektoriale (në rang kombëtar) | 8,800       | 8,800       | 8,850       |

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2023-2025 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2022. Kështu sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, nenit nr.20 dhe të shtojcës nr. 3, si dhe Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023” do të mund të kemi të dhënat e transfertës specifike si më poshtë:

*në mijë lekë*

| <b>Njësia Administrative</b> | <b>2022</b><br>(VKB Nr.71 Datë<br>24.12.2021) | <b>2023</b><br>(Shkresa nr.19206<br>prot. Datë 19.10.2022) | <b>2024</b> | <b>2025</b> |
|------------------------------|---|--|-------------|-------------|
| Bashkia Kukës                | 247,610                                       | 257,773  | 262,928     | 268,187     |

Bazuar në shkresën Nr.6937/1 prot. Datë 28.04.2022 “Dërgohet miratimi për rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2022”, transferata e veçantë për emergjencat civile për vitin 2022 për Bashkinë e Kukësit do të jetë 10 014.393 mijë lekë. Ndërsa për periudhën 2023-2025, sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025” dhe sipas shkresës Nr.6937/1 prot. Datë 28.04.2022 Bashkia duhet të planifikojë fonde për mbrojtjen civile deri në 1% të buxhetit, fond i cili do t’i bashkohet alokimeve të fondeve qendrore për Emergjencat Civile në zbatim të Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me qëllim mbrojtjen e banorëve të Bashkisë nga fatkeqësitë natyrore dhe mbrojtjen civile.

Ndërsa përsa i takon të ardhurave të veta, Formatit F1, “Parashikimi i burimeve të të ardhurave të Bashkisë Kukës” në Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.70, datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës për vitin 2022”, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.72, datë 24.12.2021 “Për miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024”, Të ardhurat e vetë Bashkisë Kukës janë parashikuar vetëm për vitet 2022-2024, nga ana e Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kukës dhe volumi i këtyre të ardhurave mbetet i njëjtë, por sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Kukës Nr.3, datë 31.01.2022 “Për miratimin e Raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Kukës” meqenëse kanë ndryshuar disa tarifa dhe taksa, **parashikohet plani për të ardhurat që do të mblidhen për tre vitet e ardhshme 2023-2025**, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me shkresën Nr.283 prot datë 04.03.2022, i është drejtuar Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kukës për të plotësuar të dhënat e të ardhurave të Bashkisë Kukës për 2023 -2025,



përgjigja me shkresat nr.333/1 Prot. datë 24.03.2022 dhe Nr.333 Prot. datë 24.03.2022 tregojnë planin e të ardhurave si në tabelën përkatëse.

*në mijë lekë*

| <b>Bashkia</b> | <b>2022</b><br>(Shkresa nr.333 prot. date<br>24.03.2022) | <b>2023 (Plan)</b><br>(Shkresa nr.333/1 prot.<br>date 24.03.2022) | <b>2024</b> | <b>2025</b> |
|----------------|--|---|-------------|-------------|
| Bashkia Kukës  | 146,581  | 146,581   | 149,513     | 152,503     |

Të ardhurat e Bashkisë Kukës janë përllogaritur për çdo burim të ardhurash veç e veç, bazuar në të dhënat historike që ka Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kukës. Duke ndjekur metodologjinë e IPF (Instrumenti i Planifikimit Financiar), përllogaritja e të ardhurave të veta merr parasysh ndikimin e rritjes ekonomike, të rritjes së popullsisë, ndryshimet rregullatore, ndryshimet e nivelit të taksave dhe shfrytëzimin e përmirësuar të potencialit të taksave (Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.3, datë 31.01.2022 “Për miratimin e Raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Kukës”). Për të ardhurat nga qeveria qendrore, përllogaritja është bazuar në informacionin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa ndryshimi i fundit që propozojmë bazohet në VKM nr.649 datë 10.10.2022 “Për propozimin e projektligjit: “Për buxhetin e vitit 2023””, Shkresën nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”.

**DREJTORI**

**Malq IMERAJ**

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

**(D1) TAVANET**

|              |  | 2023                 | 2024                 | 2025                 |     |     |     |
|--------------|--|----------------------|----------------------|----------------------|-----|-----|-----|
|              |  | Viti t+1 (I prituri) | Viti t+2 (I prituri) | Viti t+3 (I prituri) |     |     |     |
| <b>01110</b> | <b>Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 158,063              | 161,225              | 164,450              | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 60,624               | 61,835               | 63,072               | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 12,220               | 12,465               | 12,714               | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>230,907</b>       | <b>235,525</b>       | <b>240,236</b>       | OK! | OK! | OK! |
| <b>03140</b> | <b>Shërbimet e Policisë Vendore</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 25,529               | 26,040               | 26,560               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>25,529</b>        | <b>26,040</b>        | <b>26,560</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>03280</b> | <b>Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 40,150               | 40,953               | 41,772               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 19,005               | 19,385               | 19,773               | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>59,155</b>        | <b>60,338</b>        | <b>61,545</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>04130</b> | <b>Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 1,540                | 1,571                | 1,602                | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>1,540</b>         | <b>1,571</b>         | <b>1,602</b>         | OK! | OK! | OK! |
| <b>04220</b> | <b>Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</b> |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 11,539               | 11,770               | 12,005               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>11,539</b>        | <b>11,770</b>        | <b>12,005</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>04240</b> | <b>Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit</b>                                |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 1,744                | 1,779                | 1,814                | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 5,000                | 5,100                | 5,202                | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>6,744</b>         | <b>6,879</b>         | <b>7,016</b>         | OK! | OK! | OK! |
| <b>04260</b> | <b>Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 10,422               | 10,630               | 10,843               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 1,927                | 1,966                | 2,005                | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>12,349</b>        | <b>12,596</b>        | <b>12,848</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>04520</b> | <b>Rrjeti Rrugor Rural</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 6,856                | 6,993                | 7,133                | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 14,473               | 14,762               | 15,058               | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>21,329</b>        | <b>21,755</b>        | <b>22,191</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>04570</b> | <b>Transporti Publik</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
| <b>05100</b> | <b>Menaxhimi i Mbetjeve</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 14,942               | 15,241               | 15,546               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>14,942</b>        | <b>15,241</b>        | <b>15,546</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>06140</b> | <b>Planifikimi Urban Vendor</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 12,183               | 12,427               | 12,675               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>12,183</b>        | <b>12,427</b>        | <b>12,675</b>        | OK! | OK! | OK! |
| <b>06260</b> | <b>Shërbimet Publike Vendore</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  | 41,758               | 42,593               | 43,445               | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  | 109,068              | 110,582              | 112,794              | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 104,144              | 105,100              | 107,202              | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  | <b>254,969</b>       | <b>258,275</b>       | <b>263,441</b>       | OK! | OK! | OK! |
| <b>06370</b> | <b>Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
| <b>07220</b> | <b>Shërbimet e Kujdesit Parësor</b>  |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Të tjera shpenzime korrente  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
|              | Shpenzimet kapitale  | 0                    | 0                    | 0                    | OK! | OK! | OK! |
|              | <b>Tavanet e përgjithshme</b>  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |
| <b>08130</b> | <b>Sport dhe Argëtim</b>   |                      |                      |                      |     |     |     |
|              | Pagat dhe sigurimet shoqërore  |                      |                      |                      | OK! | OK! | OK! |



|   |   |                  |                  |     |     |     |
|---|---|------------------|------------------|-----|-----|-----|
| Të tjera shpenzime korrente                   | 4,306   |                  |                  | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 0   | 0                | 0                | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>4,306</b>  |                  |                  | OK! | OK! | OK! |
| <b>08220</b>                                  | <b>Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore</b> |                  |                  |     |     |     |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore                 | 14,431  | 14,720           | 15,014           | OK! | OK! | OK! |
| Të tjera shpenzime korrente                   |   |                  |                  | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 0   | 0                | 0                | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>14,431</b>   | <b>14,720</b>    | <b>15,014</b>    | OK! | OK! | OK! |
| <b>09120</b>                                  | <b>Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin</b>                   |                  |                  |     |     |     |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore                 | 133,650   | 136,323          | 139,049          | OK! | OK! | OK! |
| Të tjera shpenzime korrente                   | 1,713   | 1,747            | 1,782            | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 0   | 0                | 0                | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>135,363</b>  | <b>138,070</b>   | <b>140,831</b>   | OK! | OK! | OK! |
| <b>09230</b>                                  | <b>Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm</b>                          |                  |                  |     |     |     |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore                 | 18,760  | 19,135           | 19,518           | OK! | OK! | OK! |
| Të tjera shpenzime korrente                   | 1,473   | 1,502            | 1,533            | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 10,000  | 10,200           | 10,403           | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>30,233</b>   | <b>30,837</b>    | <b>31,454</b>    | OK! | OK! | OK! |
| <b>10430</b>                                  | <b>Përkujdesi Social</b>                                      |                  |                  |     |     |     |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore                 | 2,600   | 2,652            | 2,705            | OK! | OK! | OK! |
| Të tjera shpenzime korrente                   | 335,000   | 341,700          | 348,534          | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 0   | 0                | 0                | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>337,600</b>  | <b>344,352</b>   | <b>351,239</b>   | OK! | OK! | OK! |
| <b>10661</b>                                  | <b>Strehimi Social</b>  |                  |                  |     |     |     |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore                 | 14,004  | 14,284           | 14,570           | OK! | OK! | OK! |
| Të tjera shpenzime korrente                   | 335,000   | 341,700          | 348,534          | OK! | OK! | OK! |
| Shpenzimet kapitale                           | 0   | 0                | 0                | OK! | OK! | OK! |
| <b>Tavanet e përgjithshme</b>                 | <b>349,004</b>  | <b>355,984</b>   | <b>363,104</b>   | OK! | OK! | OK! |
| <b>TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE</b> | <b>508,171</b>  | <b>518,336</b>   | <b>528,701</b>   |     |     |     |
| <b>TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE</b> | <b>885,661</b>  | <b>898,313</b>   | <b>916,282</b>   |     |     |     |
| <b>TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE</b>          | <b>128,291</b>  | <b>129,731</b>   | <b>132,324</b>   |     |     |     |
| <b>TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME</b>      | <b>1,522,123</b>  | <b>1,546,380</b> | <b>1,577,307</b> | OK! | OK! | OK! |
| <b>MAKSIMUMI I TAVANIT</b>                    | <b>1,522,123</b>  | <b>1,552,516</b> | <b>1,583,567</b> |     |     |     |
| FONDI REZERVE NË PËRQINDJE (%)                | 0.8%  | 0.8%             | 0.8%             |     |     |     |
| FONDI REZERVE: 04910                          | 7,000   | 7,049            | 7,050            |     |     |     |
| FONDI KONTINGJENCËS NË PËRQINDJE (%)          |   |                  |                  |     |     |     |
| FONDI KONTINGJENCËS: 04940                    | 0   | 0                | 0                |     |     |     |
| <b>TOTALI FONDEVE NË PËRQINDJE (%)</b>        | <b>0.8%</b>   | <b>0.8%</b>      | <b>0.8%</b>      | OK! | OK! | OK! |
| <b>TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË</b> | <b>7,000</b>  | <b>7,049</b>     | <b>7,050</b>     |     |     |     |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 4/35 Prot.

Kukës më, 4 .01 .2023

L Ë N D A :

Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktit.

KRYETARIT TË BASHKISË

KËSHILLIT BASHKIAK

KUKËS

Bazuar në nenin 16, pika 2, shkronja “ b “ të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi verifikova kompetencën, juridiksionin dhe bazën ligjore të vendimit nr.79 të datës 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak Kukës :

V E N D O S A :

**Të konfirmoj vendimin nr.79 të datës 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak Kukës :**

**Vendim nr.79;** këshilli bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrise se Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.23 date 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, (i ndryshuar), Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”, **mori vendim:**

1. Ndryshimin e Taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, (miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022), bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55/6, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

